



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 17 qershor 2026
Nr. Ref.: AGJ3130/26

AKTGJYKIM

në

rastin KI262/25

Parashtrues

Behar Pruthi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave në lëndën
[P.2025: 116643] të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Behar Pruthi, me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Teki Bokshi, avokat me seli në Gjakovë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore, të cilat janë duke u zhvilluar pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik, përkitazi me lëndën [P.2025: 116643].

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave, të cilat janë duke u zhvilluar pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj, me pretendimin se mosvendosja e lëndës [P.2024:040378] cenon të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me dispozitat e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe nenin 1 (Mbrotjtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 29 gusht 2025, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), përmes postës elektronike.
6. Më 3 shtator 2025, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin [GJR.KI262/25], e caktoi gjyqtarin Radomir Laban, gjyqtar raportues, dhe me Vendimin [KSH.KI262/25], caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Nexhmi Rexhepi (kryesues), Enver Peci dhe Jeton Bytyqi (anëtarë).
7. Më 24 shtator 2025, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 24 shtator 2025, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga kjo e fundit që ta informojë Gjykatën përkitazi me: (i) kur është regjistruar lënda me numër [P.2024:040378]; (ii) cilat janë vendimet gjyqësore të marra nga gjykatat e rregullta në lëndën [P.2024:040378]; (iii) fazën në të cilën gjendet rasti i parashtruesit; si dhe (iv) veprimet e ndërmarra nga Gjykata Themelore përkitazi me rastin e parashtruesit të kërkesës.
9. Më 26 shkurt 2026, Gjykata Themelore i dorëzoi në Gjykatë informatat e kërkuara.
10. Më 17 mars 2026, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore dorëzimin e dosjes së plotë të rastit.
11. Më 26 mars 2026, Gjykata Themelore e njoftoi Gjykatën se dosja e rastit gjendet në Gjykatën e Apelit.

12. Më 17 mars 2026, Gjykata kërkoi nga Gjykata e Apelit dorëzimin e dosjes së plotë të rastit.
13. Më 20 prill 2026, Gjykata e Apelit dorëzoi në Gjykatë vendimin e saj [PN.nr.1981/2025] dhe e njoftoi Gjykatën se dosjen e rastit po e përcillte në Gjykatën Themelore, e cila kishte detyrim që të bëjë ekspedimin e vendimit palëve në procedurë.
14. Më 25 maj 2026, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri: (i) deklaroi kërkesën të pranueshme; (ii) konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; dhe (iii) ta urdhërojë Gjykatën e Apelit, që jo më larg se 3 (tre) muaj nga hyrja në fuqi e Aktgjykimit, të informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 të Rregullores së punës.

Përmbledhja e fakteve të rastit

15. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 6 shtator, 13 shtator dhe 9 dhjetor 2016, Policia e Kosovës, nën autorizimin e Prokurorisë, kishte kryer bastisje dhe kishte sekuestruar përkohësisht një sasi të konsiderueshme të pasurisë së parashtruesit të kërkesës (stoli ari e argjendi dhe automjete), nën dyshimin për veprat penale të kontrabandimit të mallrave dhe shmangies nga pagimi i tarifave të detyrueshme doganore.
16. Më 5 shkurt 2018, Prokuroria Themelore në Ferizaj kishte ngritur aktakuzë [PP.IL.nr.1077-3/17] ndaj parashtruesit të kërkesës dhe personave të tjerë, për shkak të veprave penale të: kontrabandimit të mallrave, shmangies nga tatimi dhe tregtisë së ndaluar (në bashkëkryerje për një grup të të pandehurve); si dhe për shkak të veprës penale: blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345, paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 të KPRK-së, për grupin e të pandehurve ku përfshihej edhe parashtruesi i kërkesës.
17. Më 12 prill 2019, Gjykata Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik, përmes Aktgjykimit [P.nr.137/18], parashtruesin e kërkesës e shpalli fajtor për veprën penale për të cilën akuzohej.
18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës dorëzoi ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur.
19. Më 10 qershor 2021, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [PA1.nr.717/19], refuzoi ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi aktgjykimin e shkallës së parë.
20. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të lartcekur.
21. Më 13 maj 2022, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Pml.nr.67/22], aprovoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe e ktheu çështjen në rigjykim në shkallë të parë.

Rigjykimi i parë

22. Më 24 tetor 2022, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [P.nr.206/22], hodhi poshtë aktakuzën ndaj parashtruesit të kërkesës, për shkak të arritjes së parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

23. Në një datë të paspecifikuar, Prokuroria Themelore dorëzoi ankesë kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore.
24. Më 6 dhjetor 2022, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [PN.nr.1210/22], e ktheu lëndën sërish në rigjykim.

Rigjykimi i dytë

25. Më 5 janar 2023, Gjykata Themelore nxori sërish Aktvendimin [P.206/22], me të cilin hodhi poshtë aktakuzën për shkak të parashkrimit absolut dhe urdhëroi kthimin e sendeve të sekuestruara.
26. Në një datë të paspecifikuar, Prokuroria Themelore dorëzoi ankesë kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore.
27. Më 15 maj 2023, Gjykata e Apelit [PN.nr.189/23] e ktheu lëndën në rigjykim vetëm sa i përket pjesës që ndërlidhet me kthimin e sendeve të sekuestruara.

Rigjykimi i tretë (vetëm lidhur me çështjen e kthimit të sendeve të sekuestruara)

28. Më 7 qershor 2023, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [P.nr. 2023: 11351], urdhëroi kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht.
29. Në një datë të paspecifikuar, Prokuroria Themelore dorëzoi ankesë kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore.
30. Më 15 janar 2024, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [PN.nr.987/23], e ktheu lëndën në rigjykim për sa i përket pjesës që ndërlidhet me kthimin e sendeve të sekuestruara.

Rigjykimi i katërt

31. Më 5 mars 2024, Gjykata Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik, përmes Aktvendimit [P. 2024:040378], kishte urdhëruar kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht sipas Urdhërësave të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda: [PPr.KR.nr.97/16] të datave 13 shtator 2016 e 9 dhjetor 2016, si dhe [UGJK.nr.187/16] të datës 6 shtator 2016.
32. Në një datë të paspecifikuar, Prokuroria Themelore në Ferizaj ushtroi ankesë kundër këtij aktvendimi për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe ligjit penal, duke i propozuar Gjykatës së Apelit që ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta anulojë aktvendimin dhe ta kthejë çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje, ose ta ndryshojë aktvendimin e ankimuar, në mënyrë që sendet e sekuestruara të konfiskohen si mjete me të cilat janë kryer veprat penale dhe si dobi pasurore e fituar përmes tyre.
33. Më 25 prill 2025, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [PN.nr. 1152/24], e ktheu lëndën në rigjykim për sa i përket pjesës që ndërlidhet me kthimin e sendeve të sekuestruara.

Rigjykimi i pestë

34. Më 30 korrik 2025, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [P.2025: 116643], urdhëroi kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht sipas Urdhërësave të Gjykatës Themelore Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda [PPr.KR.nr.97/16] të datave 13 shtator 2016 e 9 dhjetor 2016, si dhe [UGJK.nr.18/16] të datës 6 shtator 2016.

35. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj, Gjykata Themelore theksoi si në vijim: (i) *Mungesa e një aktgjykimi dënues*: për asnjërin nga të pandehurit nuk ekziston një aktgjykim dënues i formës së prerë. Për një pjesë të të akuzuarve (për veprat: 'Shmangia nga tatimi' dhe 'Tregtia e ndaluar'), procedura ka përfunduar me aktgjykim lirues që nga 10 qershori 2021, ndërsa për pjesën tjetër të të akuzuarve, përfshirë parashtruesin e kërkesës (për veprat: 'Kontrabandimi i mallrave' dhe 'Blerja/fshehja e sendeve të përfituara me vepër penale'), aktakuza është hedhur me aktvendim të formës së prerë për shkak të arritjes së parashkrimit absolut të ndjekjes penale; (ii) *Baza ligjore për kthimin e sendeve*: duke u bazuar në nenin 113 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), Gjykata vlerësoi se sendet e sekuestruara përkohësisht duhet t'i kthehen pronarit ose poseduesit kur procedura penale pushohet ose kur nuk ka bazë për konfiskimin e tyre. Pasi që procedura ndaj të pandehurve ka pushuar (përmes lirimimit ose parashkrimit), nuk ka mbetur asnjë bazë ligjore për mbajtjen e mëtejshme të tyre; (iii) *moszbatimi i dispozitave për konfiskim*: Gjykata Themelore sqaroi se dispozitat e Kodit Penal që parashohin konfiskimin e mallrave (nenet 305 dhe 317 të KPRK-së) do të gjenin zbatim vetëm nëse të pandehurit do të ishin shpallur fajtorë. Në mungesë të fajësisë së vërtetuar me aktgjykim, këto dispozita nuk mund të aplikohen në dëm të palëve; (iv) *Vlerësimi sipas nenit 276 të KPP-së (Konfiskimi automatik)*: Gjykata vlerësoi se pasuria e sekuestruar (stoli ari e argjendi dhe automjete) nuk përbën pasuri qenësisht të rrezikshme apo të paligjshme që do t'i nënshtrohej konfiskimit pa marrë parasysh fajësinë. Gjykata theksoi se këto sende nuk janë as armë, as substanca kimike apo sende të falsifikuara të krijuara me vepër penale, prandaj ato mund të jenë në qarkullim të lirë juridik (të shitën, këmbëhen ose trashëgohen); (v) *Zbatimi i parimit "in dubio pro reo"*: Gjykata Themelore nënvizoi se meqenëse asnjëri nga të pandehurit nuk është dënuar, nuk mund të konkludohet se pasuria është e paligjshme. Çdo dyshim në këtë drejtim, gjykata e ka interpretuar në favor të të pandehurve, duke konstatuar se nuk mund të provohet që këto sende janë "*dobi pasurore e fituar në mënyrë kundërligjshme*" pa një vendim meritore dënues.
36. Ndaj këtij aktvendimi, Prokuroria Themelore në Ferizaj ka ushtruar përsëri ankesë.
37. Më 14 tetor 2025, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [PN.nr.1981/25], aprovoi si të bazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, me ç'rast anuloi Aktvendimin [P.2025: 116643] e 30 korrikut 2025 të Gjykatës Themelore dhe e ktheu çështjen në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.
38. Aktualisht, rasti gjendet në Gjykatën Themelore, për rivendosje për herë të gjashtë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

39. Parashtruesi i kërkesës pretendon para Gjykatës se kohëzgjatja e procedurave të cilat janë duke u zhvilluar pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj, me pretendimin se mosvendosja e lëndës cenon të drejtat e tij, të garantuara me dispozitat e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, si dhe paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ dhe nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
40. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, si pasojë e zgjatjes së procedurave penale nga viti 2018 deri në vitin 2025. Ai thekson se pavarësisht konstatimeve të përsëritura gjyqësore se çështja ishte e gjykuar (*res judicata*) ose se ndjekja penale ishte parashkruar, pasuria e tij e sekuestruar nuk është kthyer përfundimisht për shkak të ankesave të vazhdueshme të Prokurorisë ndaj çdo aktvendimi të gjykatave të rregullta. Parashtruesi argumenton se kjo zvarritje e panevojshme gjyqësore midis shkallëve të gjyqësorit përbën shkelje

kushtetuese, duke iu referuar edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese për rastin “*Mejreme Qehaja*”.

41. Parashtruesi i kërkesës, lidhur me shkeljen e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, pretendon se i është cenuar e drejta në pronë për shkak se pasuria e tij (stoli ari e argjendi dhe mjete udhëtimi), e sekuestruar që nga viti 2016, ka mbetur nën kontrollin e autoriteteve për më shumë se nëntë (9) vjet, megjithëse nuk ekziston asnjë aktgjykim dënues i formës së prerë që do ta legjitimonte konfiskimin e saj.
42. Ai thekson se Gjykata Themelore, me Aktvendimin e 30 korrikut 2025, ka konstatuar se nuk ekziston bazë ligjore për konfiskimin dhe ka urdhëruar kthimin e pasurisë, duke u mbështetur edhe në parimin *in dubio pro reo*. Në vijim, ai pretendon se mbajtja e pasurisë edhe pas pushimit të procedurës penale cenon thelbin e të drejtës së pronës, duke e privuar atë nga shfrytëzimi i pasurisë në kundërshtim me parimet e sigurisë juridike dhe praktikën e GJEDNJ-së (rastet *Kushoglu kundër Bullgarisë*, *Smirnov kundër Rusisë* dhe *Bakan kundër Turqisë*).
43. Më tej, parashtruesi pretendon se, si pasojë e shkeljeve të të drejtave elementare njerëzore dhe dhimbjeve shpirtërore të shkaktuara nga vonesat, atij i takon kompensimi i dëmit jomaterial. Ai kërkon shumën prej dhjetëmijë (10,000.00) euro, duke arsyetuar se kjo kërkesë bazohet në mungesën e një ligji kombëtar për mbrojtjen e të drejtave për shkak të shkeljes së të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm.
44. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) ta deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm dhe nenit 46 (Mbrojtja e Pronës) të Kushtetutës; dhe (iii) që Republika e Kosovës t’ia kompensojë parashtruesit të kërkesës shumën prej dhjetëmijë (10.000,00) euro.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“[...]

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. [...]”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

45. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
46. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

47. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me nenet: 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

48. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston kohëzgjatjen e procedurës përkitazi me lëndën [P.2025: 116643] që është duke u zhvilluar pranë Gjykatës Themelore. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit. Në lidhje me afatin për paraqitjen e kërkesës, Gjykata, duke pasur parasysh natyrën e pretendimit kryesor të parashtruesit, gjegjësisht kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore pranë DHPGJS-së, thekson se në rrethana të tilla nuk kërkohet përmbushja e kriterit të përcaktuar me nenin 49 (Afatet) të Ligjit, përkatësisht kriteri për dorëzimin e kërkesës brenda afatit kohor prej katër (4) muajsh, pasi lënda është ende në zhvillim e sipër.

49. Përveç kritereve të përcaktuara në Ligj, Gjykata shqyrton tutje nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

Rregulli 34
(Kriteret e pranueshmërisë)

*“(1) Gjykata mund ta konsideroj një kërkesë të pranueshme, nëse:
(...)”*

(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

50. Gjykata thekson se kërkesa i plotëson kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me paragrafin 1 të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës dhe se e njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara nëpërmjet paragrafit 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës. Për më tepër dhe në fund, Gjykata thekson se kërkesa nuk mund të shpallet e papranueshme mbi asnjë bazë tjetër. Prandaj, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të vlerësohen meritat e saj.

Meritat e kërkesës

51. Gjykata fillimisht rikujton se rrethanat e rastit ndërlidhen me sekuestrimin e pasurisë së parashtuesit të kërkesës dhe personave të tjerë (stoli ari e argjendi dhe automjete) gjatë bastisjeve të kryera në shtator dhe dhjetor të vitit 2016, nën dyshimin për vepra penale të kontrabandimit të mallrave, shmangies nga pagimi i tarifave të detyrueshme doganore dhe veprave të tjera të ndërlidhura. Më 5 shkurt 2018, Prokuroria Themelore në Ferizaj ngriti aktakuzë, ndërsa më 12 prill 2019, Gjykata Themelore e shpalli parashtuesin fajtor. Pas vërtetimit të dënimit nga Gjykata e Apelit në vitin 2021, Gjykata Supreme e ktheu lëndën në rigjykim më 13 maj 2022. Gjatë procesit të rigjyimit, Gjykata Themelore nxori pesë (5) aktvendime radhazi (nga tetori 2022 deri në korrik 2025), urdhëroi kthimin e sendeve të sekuestruara, duke arsyetuar se nuk ekziston aktgjykim dënues i formës së prerë dhe se, në përputhje me nenin 113 të Kodit të Procedurës Penale, nuk ka bazë ligjore për mbajtjen apo konfiskimin e mëtejshëm të tyre. Gjykata Themelore theksoi gjithashtu se dispozitat e Kodit Penal për konfiskim nuk mund të aplikohen në mungesë të një vendimi dënues dhe se sendet e sekuestruara nuk përbëjnë pasuri që i nënshtrohet konfiskimit automatik. Megjithatë, për shkak të ankesave të vazhdueshme të Prokurorisë, Gjykata e Apelit e ka kthyer lëndën pesë (5) herë në rigjykim, duke bërë që çështja e kthimit të pasurisë të mbetet ende në shqyrtim pranë Gjykatës Themelore.
52. Lidhur me këtë, parashtuesi i kërkesës pretendon se, si rezultat i kohëzgjatjes së procedurave përkitazi me lëndën e tij (2016–2025), atij i është shkelur (i) e drejta për një gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe (ii) e drejta në pronë, e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, pasi është privuar nga gëzimi i pasurisë së tij për rreth 9 vjet, pa një aktgjykim dënues.
53. Andaj, Gjykata në vazhdim do të trajtojë këtë pretendim të parashtuesit të kërkesës, në bazë të parimeve të përgjithshme të përcaktuara përmes praktikës së saj gjyqësore, por edhe asaj të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i

Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

Parimet e përgjithshme përkritazi me të drejtën për vendim brenda një afati të arsyeshëm

54. Gjykata fillimisht rikujton se paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës përcakton: “Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme [...]”.
55. Ndërsa, paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së përcakton se “Çdo person ka të drejtë që [...] të dëgjohet [...] brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë [...], e cila do të vendosë [...] në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij [...] civile [...]”.
56. Bazuar në dispozitat e lartcekura, e drejta për një vendim brenda një afati të arsyeshëm është pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
57. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton që parimet dhe kriteret e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në kontekst të së drejtës për vendim brenda afatit të arsyeshëm kohor në rastet penale i ka aplikuar në rastin [KI75/23 dhe KI225/23](#) (parashtrues *Ilir Efendija dhe Ilir Beqiri*, Aktgjykim i 5 shkurtit 2025). Thënë këtë, Gjykata në aplikimin parimeve dhe standardet e GJEDNJ-së ka theksuar se qëllimi i paragrafit 2 të nenit 31 të ndërlidhur me nenin 6 të KEDNJ-së, me të cilin garantohej e drejta e secilit për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor, është që të sigurojë se i akuzuari nuk do të mbetet për shumë gjatë nën akuzë, në gjendje të pasigurisë në lidhje me vendimin ndaj tij. Neni 6 nuk parasheh ndonjë të drejtë në lidhje me rezultatin e procesit penal (shih rastin e lartcekur më lartë [KI75/23 dhe KI225/23](#) të Gjykatës; dhe rastin e GJEDNJ-së, [Kart kundër Turqisë](#), nr.8917/05, Aktgjykim i 3 dhjetorit 2009, paragrafi 68).
58. Në procedurën penale, koha e arsyeshme për zgjidhjen e çështjes sipas paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës, ndërlidhur paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së fillon nga momenti kur personi akuzohet. Akuza konsiderohet se ekziston nga momenti kur individi njoftohet zyrtarisht nga autoritetet kompetente për dyshimin se ai ka kryer veprë penale, ose nga momenti kur ai është prekur në mënyrë substanciale nga veprimet e autoriteteve publike si rezultat i dyshimit serioz ndaj tij (shih, rastin e Gjykatës [KI75/23 dhe KI225/23](#), cituar më lart, paragrafi 92 dhe rasti i GJEDNJ-së, [Kaleja kundër Latvisë](#), nr.22059/08, Aktgjykim i 5 tetorit 2017, paragrafi 36).
59. Thënë këtë, Gjykata bazuar në kriterin e vendosur nga GJEDNJ-së ka vlerësuar se periudha që merret parasysh përfshin të gjithë procesin penal në tërësi, përfshirë edhe procedurën e ankimit (shih, rastin e Gjykatës [KI75/23 dhe KI225/23](#), cituar më lart, paragrafi 92 dhe rastin e GJEDNJ-së, [Konig kundër Gjermanisë](#), nr. 6232/73, Aktgjykim i 28 qershorit 1978, paragrafi 98).
60. Gjykata ka specifikuar që arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës penale duhet të vlerësohet në bazë të rrethanave të rastit, që kërkon një vlerësim të përgjithshëm, megjithatë ashtu siç ka specifikuar edhe GJEDNJ, në kontekstin e administrimit të mirëfilltë të drejtësisë kërkohet një balancim i drejtë i disa aspekteve që janë fundamentale. Thënë këtë, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet mbi bazën e kriterëve siç janë: (i) ndërlikueshmëria e rastit, (ii) sjellja e palës, (iii) sjellja e autoriteteve dhe (iv) ajo se çfarë është në rrezik për palën e akuzuar (shih, rastin e Gjykatës [KI75/23 dhe KI225/23](#), cituar më lart, paragrafët 92-93 dhe referencat e përdorura aty si rasti i GJEDNJ-së, [Boddaert kundër Belgjikës](#), nr. 12919/87,

Aktgjykim i 12 tetorit 1992, paragrafët 36 dhe 39 dhe [Idalov kundër Rusesë](#), nr. 5826/03, Aktgjykim i 22 majit 2012, paragrafi 186).

a) ndërlikueshmëria e rastit

61. Në këtë drejtim, GJEDNJ në rrethana konkrete të rasteve kishte vlerësuar se ndërlikueshmëria e rastit mund të përcaktohet nga faktorë të ndryshëm si numri i akuzave, numri i personave të përfshirë në procedurën penale (të akuzuarit apo dëshmitarët) (shih, rastin e Gjykatës [KI75/23 dhe KI225/23](#), cituar më lart, paragrafët 80-83 dhe rastin e GJEDNJ-së, [Neumeister kundër Austrisë](#), nr.1936/63, Aktgjykim i 27 qershorit 1968, paragrafi 20); apo kur akuzat penale lidhen me shpëlarjen e parave (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Arewa kundër Lituanisë](#), nr. 16031/18, Aktgjykim i 9 marsit 2021, paragrafi 52). Megjithatë, ndërlikueshmëria e rastit, siç mund të jenë akuzat për krim të organizuar, ku janë të përfshirë numër i madh i të akuzuarve, megjithatë nuk mund të përbëjë shkak për ta arsyetuar gjithë kohëzgjatjen e procesit penal (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Rutkowski dhe të tjerët kundër Polonisë](#), nr. 72287/10, 13927/11 dhe 46187/11, Aktgjykim i 7 korrikut 2015, paragrafi 137).

b) sjellja e autoriteteve

62. Përderisa lidhur me sjelljen e autoriteteve, Gjykata duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së thekson se është detyrë e shtetit të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të tillë që do t'i mundësonte gjykatave të përfundojnë çështjen brenda afatit të arsyeshëm kohor (shih, rastin e Gjykatës [KI75/23 dhe KI225/23](#), cituar më lart, paragrafët 84-85 dhe rastin e GJEDNJ-së, [Dimitrov dhe Hamanov kundër Bullgarisë](#), nr. 48059/06 dhe 2708/09, Aktgjykim i 19 majit 2011, paragrafi 71). Thënë këtë, gjykatat mbajnë përgjegjësi për mospjesëmarrjen e palëve të përfshira në procesin penal, si të akuzuarit, përfaqësuesit e tyre apo dëshmitarët (shih, rasti i GJEDNJ-së, [Tychko kundër Rusesë](#), nr.56097/07, Aktgjykim i 11 qershorit 2015, paragrafi 68).

c) sjellja e palës

63. Në vijim dhe lidhur me sjelljen e palëve, Gjykata duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së ka afirmuar se në rrethanat e rasteve penale me nenin 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së nuk kërkon që palët të bashkëpunojnë aktivisht me autoritetet gjyqësore kompetente; dhe as nuk mund të fajësohen palët për përdorimin e të gjitha mjeteve juridike në dispozicion. Megjithatë, këto veprime nuk mund t'i atribuohen autoriteteve dhe duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit nëse procedura ka zgjatur përtej afatit të arsyeshëm (shih, rastin e Gjykatës [KI75/23 dhe KI225/23](#), cituar më lart, paragrafët 92-93 dhe rastin e GJEDNJ-së, [Eckle kundër Gjermanisë](#), nr. 8130/78, Aktgjykim i 15 korrikut 1982, paragrafi 82).

d) Rëndësia e asaj se çfarë është në rrezik për palën në procedurë

64. Në fund, dhe lidhur me kriterin e asaj se çfarë është në rrezik për palën, Gjykata rikujton vlerësimin e GJEDNJ-së ku ka theksuar se ajo se çfarë është në rrezik për palën duhet të merret si faktorë për ta përcaktuar arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit penal. Për shembull, kur një person është në vuajtje të paraburgimit, autoritetet duhet të veprojnë me shpejtësi dhe kujdes të shtuar (shih, rastin e Gjykatës [KI75/23 dhe KI225/23](#), *parashtrues Ilir Efendija dhe Ilir Beqiri*, cituar më lart, paragrafi 97 dhe rastin e GJEDNJ-së, [Abdoella kundër Holandës](#), nr.12728/87, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992, paragrafi 24).

Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

Periudha që do të merret parasysh

65. Lidhur me këtë, Gjykata rithekson se rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me sekuestrimin e pasurisë së parashtruesit të kërkesës (stoli ari e argjendi dhe automjete) që nga shtatori dhe dhjetori i vitit 2016. Pas ngritjes së aktakuzës në vitin 2018 dhe shpalljes fajtor në vitin 2019, procesi pësoi një kthesë me vendimin e Gjykatës Supreme të 13 majit 2022, e cila e ktheu lëndën në rigjykim. Që nga ajo kohë, procedurat janë përqendruar në çështjen e kthimit të sendeve të sekuestruara, ku pavarësisht pesë (5) aktvendimeve të Gjykatës Themelore për kthimin e tyre, ankesat e përsëritura të Prokurorisë kanë bërë që lënda të mbetet ende e pazgjidhur me një vendim të formës së prerë deri më 29 gusht 2025 (datë kjo kur parashtruesi e kishte dorëzuar kërkesën në Gjykatë).
66. Prandaj, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson se lënda e parashtruesit të kërkesës ka filluar me sekuestrimin e parë në vitin 2016, ka vazhduar nëpër të gjitha shkallët gjyqësore dhe aktualisht gjendet në rigjykimin e gjashtë në Gjykatën Themelore, pas Aktvendimit [PN.nr. 1981/25] të 14 tetorit 2025 të Gjykatës së Apelit. Rrjedhimisht, periudha që do të merret parasysh nga Gjykata për vlerësimin e kohëzgjatjes së procedurës është periudha nga shtatori i vitit 2016 deri në tetor të vitit 2025, që përfshin një kohëzgjatje prej më shumë se 9 (nëntë) vjetësh.
67. Gjykata, për të ardhur në përfundim nëse në rastin e parashtruesit të kërkesës, rasti i tij ishte trajtuar brenda afatit të arsyeshëm, në vijim do të vlerësojë: (i) kompleksitetin e rastit, (ii) sjelljen e palëve në procedurë, (iii) sjelljen e autoriteteve shtetërore, si dhe (iv) rëndësinë e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor.

(i) Përkitazi me ndërlikueshmërinë e rastit

68. Për sa i përket ndërlikueshmërisë së çështjes, Gjykata, bazuar në shkresat e lëndës, vëren se rasti konkret ka përfshirë një numër të madh të të pandehurve në procedurat gjyqësore në gjyqësorin e rregullt dhe disa vepra penale që ndërlidhen me kontrabandimin e mallrave dhe shmangien tatimore, të cilat, për nga natyra, kërkojnë administrim të gjerë të provave dhe dëshmimeve. Kompleksiteti i rastit është shtuar edhe për shkak të procedurave të shumta të ankimimit, përfshirë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, si dhe faktin që pasuria e sekuestruar përbëhet nga kategori të ndryshme (stoli ari e argjendi etj), gjë që ka kërkuar vlerësime të veçanta për secilën kategori në raport me origjinën e tyre të pretenduar kriminale.
69. Megjithatë, Gjykata vlerëson se, pavarësisht ekzistimit të një niveli të caktuar kompleksiteti për shkak të numrit të të pandehurve dhe natyrës së veprave penale, çështja nuk ka natyrë të tillë që të justifikojë një procedurë me kohëzgjatje prej më shumë se 9 (nëntë) vjetësh, sidomos kur merret parasysh se pas vitit 2022, procedura është kufizuar vetëm në çështjen e kthimit të sendeve të sekuestruara pas parashkrimit të ndjekjes penale. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, kompleksiteti i rastit nuk mund të shërbejë si arsye për vonesa të stërzgjatura që vijnë si pasojë e kthimit të përsëritur të lëndës në rigjykim (gjashtë herë në shkallë të parë). Një kohëzgjatje e tillë tejkalon kufijtë e një afati të arsyeshëm dhe tregon se sistemi gjyqësor nuk ka arritur të japë një epilog përfundimtar mbi statusin e pasurisë së sekuestruar, duke cenuar parimin e efikasitetit gjyqësor.

(ii) Përkitazi me sjelljen e palës

70. Lidhur me sjelljen e palëve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka treguar një interes të vazhdueshëm dhe aktiv për zgjidhjen e çështjes së tij, duke ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion. Gjykata rikujton se parashtruesi ka ndjekur rrugët ligjore deri në Gjykatën Supreme për të sfiduar aktgjykimin dënues, veprim ky që rezultoi i suksesshëm me kthimin e lëndës në rigjykim. Pas parashkrimit të ndjekjes penale në vitin 2022, parashtruesi ka qenë vazhdimisht aktiv në kërkimin e kthimit të pasurisë së sekuestruar, duke iu përgjigjur proceseve të rigjyimit të përsëritura pesë (5) herë radhazi në shkallë të parë dhe tashmë është në pritje të rigjyimit të gjashtë.
71. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se zvarritja e procedurës për gati 9 (nëntë) vjet nuk mund t'i mvishet sjelljes së parashtruesit. Përkundrazi, vonesat kanë ardhur si pasojë e dinamikës ndërmjet Prokurorisë dhe gjykatave të rregullta, ku parashtruesi ka mbetur në një pritje pasive për ekzekutimin e vendimeve që urdhëronin kthimin e pasurisë së tij. Nuk rezulton nga shkresat e lëndës që parashtruesi të ketë përdorur mjete procedurale me qëllim të zvarritjes së procesit, të ketë munguar në seanca apo t'i ketë neglizhuar detyrimet e tij.

(iii) Sjellja e autoriteteve kompetente

72. Gjykata, në vlerësimin e sjelljes së autoriteteve kompetente, thekson se institucionet gjyqësore dhe ato të ndjekjes kanë dështuar të sigurojnë një epilog përfundimtar lidhur me pasurinë e sekuestruar të parashtruesit. Veçanërisht pas vitit 2022, kur çështja penale mori fund si pasojë e parashkrimit, Gjykata vëren një cikël të përsëritur të kthimit të lëndës në rigjykim (gjashtë herë në shkallë të parë). Këto veprime procedurale, ku Gjykata e Apelit ka anuluar pesë herë radhazi vendimet e Gjykatës Themelore për kthimin e sendeve, dëshmon për një mungesë efikasiteti dhe koordinimi në interpretimin e bazës ligjore për konfiskimin ose kthimin e pasurisë. Arsyetimet e mundshme mbi mbingarkesën e gjykatave apo kompleksitetin e lëndës nuk mund të justifikojnë faktin e tejzgjatjes prej më shumë se 9 (nëntë) vjetësh të këtij rasti, periudhë gjatë së cilës pasuria e parashtruesit ka mbetur nën sekuestrim.
73. Gjykata vëren se veçanërisht pas vitit 2022, kur ndjekja penale mori fund si pasojë e parashkrimit, autoritetet kanë hyrë në një cikël të pafundmë rigjykimesh dhe ankesash që kanë pamundësuar vendimmarrjen për marrjen e vendimeve për kthimin e sendeve. Kjo zvarritje institucionale, që tashmë ka tejkaluar afatin prej nëntë vjetësh, dëshmon për një dështim në administrimin e drejtësisë. Sipas praktikës së konsoliduar të GJEDNJ-së, vështirësitë administrative apo mbingarkesa e sistemit nuk e lirojnë shtetin nga detyrimi për të organizuar sistemin e tij gjyqësor në atë mënyrë që të garantojë gjykimin e çështjeve brenda një afati të arsyeshëm, sidomos kur në lojë është privimi i stërzgatur nga e drejta në pronë.

(iv) Përkitazi me rëndësinë e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor

74. Lidhur me këtë kriter, Gjykata ka sqaruar kategoritë e caktuara të rasteve të cilat për nga natyra e tyre duhet të trajtohen me kujdes të veçantë. Ndonëse sekuestrimi i pasurisë në procedurë penale është një masë e përkohshme, Gjykata thekson se mbajtja e pasurisë nën kontrollin e autoriteteve për një periudhë prej më shumë se 9 (nëntë) vjetësh, veçanërisht pasi ndjekja penale ka pushuar, përbën një barrë të rëndë dhe pasiguri juridike për parashtruesin sa i përket gëzimit të të drejtës së tij në pronë.
75. Thënë këtë, Gjykata thekson se kohëzgjatja e trajtimit të çështjes së kthimit të sendeve, ku pas gjashtë (6) rigjyimeve ende nuk ka një vendim të formës së prerë, shpërfaq një prolongim që është në kundërshtim të plotë me të drejtën e parashtruesit të kërkesës

për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm, ashtu siç garantohet nga paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së.

76. Si përfundim, Gjykata, marrë parasysh aplikimin kumulativ të kriterëve të lartcekura, konstaton se: (i) megjithëse rrethanat e rastit fillimisht ishin komplekse për shkak të numrit të të pandehurve, faza e kthimit të sendeve nuk rezultoi të jetë e një natyre aq të ndërlikuar sa të justifikojë një tejzgjatje prej më shumë se 9 vjetësh; (ii) parashtruesi i kërkesës nuk ka kontribuar në këtë vonesë, por ka ndjekur me rregull të gjitha shkallët gjyqësore; ndërsa (iii) autoritetet gjyqësore, përmes ciklit të pafundmë të kthimit të lëndës në rigjykim, kanë dështuar t'i japin epilog kërkesës për kthimin e pasurisë.
77. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se në rrethanat e parashtruesit të kërkesës, autoritetet gjyqësore kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
78. Duke qenë se Gjykata konstatoi shkelje të së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ajo nuk e sheh të nevojshme të vlerësojë veçmas pretendimet për shkeljen e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës], pasi konstatimi i shkeljes procedurale adreson thelbin e ankesës së parashtruesit lidhur me zvarritjen e kthimit të pasurisë.
79. Gjykata gjithashtu thekson se përfundimi i lartcekur ekskluzivisht ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurave sa i përket shqyrtimit të rastit të parashtruesit të kërkesës, dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e meritave (nëse sendet duhet të konfiskohen apo të kthehen përfundimisht) para gjykatave të rregullta.

Përkitazi me kërkesën për kompensim

80. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar edhe që Republika e Kosovës t'ia kompensojë parashtruesit të kërkesës shumën prej 10,000.00 (dhjetëmijë) euro “*në emër të dhimbjeve shpirtërore*”.
81. Lidhur me këtë, Gjykata ka ripërsëritur se nuk ka autorizime ligjore për caktimin e ndonjë lloji të kompensimit për rastet në të cilat konstaton shkelje të Kushtetutës dhe KEDNJ-së si pasojë e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore (shih rastet: [KI19/21](#), cituar më lart, paragrafi 115; [KI06/21](#), cituar më lart, paragrafi 84; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 68).
82. Gjykata përsërit se në disa raste gjetja e shkeljes kushtetuese paraqet një lloj të “*shpërblimit të drejtë*”, sidomos kur parashtruesi ka mundur të pësojë një dëm jomaterial. Megjithatë, individët mund të kërkojnë dëmshpërblim nga autoritetet publike në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese. Në rastet kur vetëm konstatimi i shkeljes nuk mjafton dhe kompensimi monetar është i domosdoshëm, individët kanë të drejtë të përdorin mjetet juridike në dispozicion për realizimin e të drejtave të tyre, përfshirë kompensimin e dëmit material dhe jomaterial pranë gjykatave të rregullta (shih rastet e Gjykatës: [KI06/21](#), cituar më lart, paragrafi 85 dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 69).
83. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se, pas këtij Aktgjykimi, nëpërmjet të cilit konstatohet shkelja e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, DHPGJS-ja duhet të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për ta përmbyllur çështjen juridike të parashtruesit të kërkesës me prioritet, dinamikë të shtuar dhe brenda një afati sa më të shpejtë kohor, konform gjetjeve të këtij Aktgjykimi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit, si dhe rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 25 maj 2026, njëzëri:

VENDOS

- I. TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor;
- III. TA URDHËROJË Gjykatën e Apelit, që jo më larg se 3 (tre) muaj nga hyrja në fuqi e Aktgjykimit, ta informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 të Rregullores së punës;
- IV. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;
- V. TË KONSTATOJË se ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Radomir Laban

Nexhmi Rexhepi